



01 Nr. 440/26 Dt. 10.09.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu” në Prizren, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Burim Mustafa-drejtor i TQ “Bekim Fehmiu”, për pjesëmarrje në edicionin e 4-të të “Independent Theatre Showcase of Istanbul”, që është mbajtur nga data 16 tetor 2026 deri me 20 tetor 2026 në Stamboll të Republikës së Turqisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, pagesa e biletës (aeroplanit) të ushqimit, pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, TQ “Bekim Fehmiu” dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Teatrit të Qytetit,
 - Arkivës së Kryetarit.

